



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:268665

Datë: 19.02.2020

Numri i dokumentit: 00839817

Pnr. 1019/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA VUSHTRRI, Gjyqtari Ferki Xhaferi, me pjesëmarrjen e sekretares juridike - praktikantës Doruntina Maloku , duke vendosur në lëndën penale ndaj të akuzuarit Y. T. nga fshati S. komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale Vjedhje e Pyllit nga neni 358 par par.1 te KPRK- se, duke vendosur sipas aktakuzës se Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, PP.II-nr.2817/19 dt. 11.11.2019, dhe kërkesës për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor të paraqitur në të njëjtën aktakuzë, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, në mbështetje të nenit 385 të KPRK-së, me datë 12.12.2019, nxjerre këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, dhe ipet

URDHËRI NDESHKIMOR

Kundër të akuzuarit:

Y.T. nga i ati A., i lindur me ..., me vendbanim në fshatin S. komuna e Vushtrrisë, me nr. personal, Kosovar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me datën datë 21.04.2018 rreth orës 12:30 ,ne pyllin – prone e Komunës ne territorin e fshatit S. ne vendin e quajtur “S.”, është zënë duke i prerë drutë, 96 trungje të sasisë totale 4.80 m³, lloji i drurit “Ahu” të diametrit 12-14 cm, lartësisë 9m, ku dëmi total është në vlerë prej 734,40 euro, këtë veprim e ka kryer pa leje, me qëllim që ti vjedh, në këtë mënyrë ka kryer veprën penale Vjedhja e Pyllit nga neni 358 par 1 i KPRK

Me këtë ka kryer veprën penale Vjedhje e pyllit nga neni 358 par .1 të KPRK- së.

Andaj gjykata komformë dispozitave të neneve 7,17, 41, 43, 46 te KPRK-së dhe nenit 365 e 495 të KPPK-ës,

G J Y K O N

DENIM MË GJOBË në shumë prej 600 € (Gjashtëqind euro), të cilin dënim do ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, Gjykata do të zëvendësoi dënimin me gjobë me dënim me burgim duke llogaritur 20€, për një ditë të kaluar me burg.

I akuzuari obligohet që në emër të kompensimit të dëmit, të dëmtuarës Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim – Pylltaria, zyra në Vushtri, t'ia paguaj shumën prej 734.40 €, ndërsa në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 20€,(njëzet euro), si dhe në emër të kompensimit të viktimave të kimit të paguaj shumën prej 30 (tridhjetë) euro. Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë Departamenti i përgjithshëm, ka parashtruar Aktakuzën nr. PP.II-nr. 2817/19 dt. 11.11.2019, po ashtu është parashtruar edhe kërkesa për shqiptimin e urdhrin ndëshkimor, kundër të pandehurit Y.T., për shkak të veprës penale Vjedhje e pyllit nga neni 358 par .1 të KPRK- së.

Gjykata shqyrtoj Aktakuzën dhe kërkesën për shqiptimin e urdhrin ndëshkimor dhe gjeti se Aktakuza dhe kërkesa janë të bazuar në baze të nenit 495 të KPPK-se, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 i KPP-ës, që pa u mbajtur shqyrtimi gjyqësor të merr vendim për urdhër ndëshkimorë si në dispozitiv, pasi që nga shkresat e lëndës vërtetohet se ka prova të mjaftueshme, të cilat vërtetojnë fajësinë e të akuzuarit se ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë sipas Aktakuzës së Prokurorit të Shtetit.

Gjykata, vlerëson se në rastin konkret ekzistojnë provat të cilat janë të mjaftueshme e për të vërtetuar fajësinë e të pandehurit, se ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet, sipas aktakuzës së prokurorisë, kjo vërtetohet nga provat si vijojnë dhe atë: Fletëparaqitje për dëmtimin e pyllit i datës 21.04.2018 si dhe Vlerësimi dhe llogaritja e dëmit në pyll i datës 14.05.2018

Sipas KPRK-se, për vepra penale – Vjedhje e pyllit nga neni 358 par 1 të KPRK-ës, dënimi për këtë veprë penale është dënim me gjobë ose burgim deri në një (1) vit.

Me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë gjykata mori parasysh rrethanat: si shkallën e përgjegjësisë penale, dhe faktin se i akuzuari është i njohur për vepra penale të kësaj natyre.

Gjykata në përputhje me nenin 73 të KPRK-se, me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë, vlerësoj rrethanat në matjen e dënimit, duke vlerësuar se një dënim i tillë është adekuat dhe është i përballueshëm për të akuzuarin në raport me gjendjen e tij ekonomike dhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, i cili parashihet me nenin 41 të KPRK-ës.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor, gjykata e mori komform nenit 450 të KPP-ës.

Nga theksimet e theksuara si me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE DEGA VUSHTRRI

**Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal
P.nr.1019/19 dt.12.12.2019.**

**Sekretarja juridike- Praktikantja
Doruntina Maloku**

**GJYQTARI
Ferki Xhaferi**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi në afate prej 8 ditëve nga dita e marrjes me shkrim. Kundërshtimi i drejtohet kësaj.